



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 17 dhe nenit 40, pika 40.2 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 22, pika 22.2 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor, të dispozitave të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin e Ligjit nr. 2003/14, për planifikimin hapësinor dhe të dispozitave të nenit 34, pika 34.1 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kryetari i Kuvendit të Komunës së Prishtinës, më 14.7.2011, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**P Ë R**

**NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN TË LAGJES**  
**“MATI 1”**

**I. MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues urban të lagjes “Mati 1” në Prishtinë, 01. nr. 35 - 642, të dt. 1.4.2010.

**II.** Ndryshimi dhe plotësimi i planit të cekur në pikën I të këtij Vendimi, nënkupton: luajtjen e trasesë së rrugës, të përcësve të infrastrukturës dhe pozitës së tyre në hapësirë, si dhe harmonizimet tjera të ngjashme të planit, me qëllim të arritjes së zbatimit të tij racional.

**III.** Me ndryshimet dhe plotësimet e cekura në pikën II të këtij Vendimi, hapësira e liruar nga lëvizja e trasesë së rrugës, mundëson që destinimi i sipërfaqes së liruar dhe i parcelave të formuara të jetë zonë e ndërtimit, me koeficient të ndërtimit 3.6, koeficient ky i paraparë për pronat e afërta në Planin rregullues urban të lagjes “Mati 1”.

**IV.** Ndryshimet dhe plotësimet e cekura në pikën III të këtij Vendimi, do të bëhen në parcelat kadastrorë nr. 689 - 2, 685 - 2, 685 - 4, 685 - 5 dhe 1407 - 2, të parapara në Planin rregullues të lagjes “Mati 1”.

**V.** Ky Vendim është bazë për lëshimin e kushteve urbanistike dhe të lejes së ndërtimit për pronarët e komunitetit në zonën e lagjes “Mati 1”.

**VI.** Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrotjtjes së Mjedisit, Drejtoria e Infrastrukturës Lokale dhe Drejtoria e Financave dhe Pronës.

**VII.** Ky Vendim hyn në fuqi ditën e marrjes se tij nga Kuvendi i Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. Nr. 031 - 1678, më 20.07.2011**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**

### **A r s y e t i m**

Ndërtimi i rrugës "B" në lagjen "Mati 1", ka ndikuar që të behet lëvizja e trasesë së rrugës, për të cilën arsye është paraqitur nevoja e rregullimit të çështjeve pronësore dhe të ndryshimit të infrastrukturës - zgjidhjen e çështjes së ujit të pijes.

Nga lëvizja e cekur më lart, janë krijuar kushtet që destinimi i sipërfaqes së liruar dhe i parcelave të formuara, të jetë zonë e ndërtimit, me koeficient të ndërtimit të paraparë për pronat e afërta në Planin rregullues urban të lagjes "Mati 1".

Për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Plani kontribut ka dhënë hartuesi i Planit rregullues urban të lagjes "Mati 1", duke propozuar që në sipërfaqet e liruara dhe parcelat e formuara, të mundësohet dhënia e lejes së ndërtimit nga organi kompetent i Komunës, sipas koeficientit të ndërtimit 3.6, koeficient ky i paraparë për pronat e afërta në Planin rregullues urban të lagjes "Mati 1".

Për të theksuarën, ky Vendim i dërgohet: Komitetit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për miratim.